



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 4 Maj 2021

Nr. 334

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në nenin 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ndaj zj. Frida Krifca, Drejtore e Përgjithshme e AZHBR-së,

Kërkues: denoncues

Ndaj: Zj. Frida Krifca, Drejtore e Përgjithshme e AZHBR-së,

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n”, pika 2 dhe 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREJ:

I. Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar një kallëzim nga një denoncues, me objekt “Refuzim Transferimi”, për shkelje të nenit 91, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Sipas denoncimit të datës 12.4.2021, administruar në KQZ me nr. 3638 prot., pretendohet se:



“Drejtoresha e Përgjithshme e AZHBR-së, me urdhrin nr. 101, datë 1.4.2021 ka bërë transferimin e denoncuesit nga Agropika Gjirokastër në Agropikën Kukës, në shkelje flagrante të legjislacionit, përkatësisht të nenit 48 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe nenit 91/3 të Kodit Zgjedhor”.

Sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;

f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;

n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk i’ a një shprehimisht Rregullatorit apo Kas-it.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga denoncuesi përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II. Rrethanat e faktit

Referuar denoncimit të mësipërm Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 3638/1 prot., datë 15.4.2021, ka kërkuar informacion Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, në lidhje me urdhrin e sipërcituar për sa i përket transferimit dhe procedurën e ndjekur.

Me shkresën nr. 1286/3 prot., datë 20.4.2021, administruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me nr. 4202 prot., datë 22.4.2021, znj. Frida Krifca, Drejtore e Përgjithshme e AZHBR-së, ka sqaruar se: “Urdhri nr. 101, datë 1.4.2021 “Për shpërndarjen e Sektorit të Kontrollit për Skemat Kombëtare në Rrethe”, nuk konsiderohet transferim i përkohshëm referuar rasteve të renditura në nenin 48 “Transferim i Përkohshëm” dhe as rasteve të përmendura në nenin 49 “Transferim i Përhershëm”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Sipas urdhrin nr. 101, datë 20.4.2021, nëpunësi urdhërohet të kryejë detyrat e tij funksionale sipas Rregullores së Brendshme, e cila përcakton se sipas rasteve nëpunësi dërgohet me shërbim jashtë vendit të punës.



Ky urdhër është ngritur me synim mbarëvajtjen e punës në institucion si pasojë e hapjes së thirrjes për Skemat Kombëtare 2021, proces i nisur në datën 24.3.2021 dhe ka qenë aktiv deri në 15.4.2021, ku janë përfshirë përveç inspektorëve të kontrollit dhe nëpunës të tjerë të cilët asistuan në aplikime”.

Bashkëlidhur informacionit është dorëzuar formulari i përshkrimit të punës së denoncuesit dhe urdhri nr. 101, datë 1.4.2021 “Për shpërndarjen e inspektorëve të sektorit të kontrollit për skemat kombëtare në rrethe”.

III. Analiza ligjore

Neni 91, pika 3, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se: *“Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë”.*

Referuar nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, nëpunësi civil mund të transferohet, përkohësisht, **në një pozicion tjetër të shërbimit civil**, të së njëjtës kategori, për **këto arsye dhe kohëzgjatje:**

- a) në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 viteve;
- b) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 viteve;
- c) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzënisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme sipas vendimit të komisionit përkatës.

Gjatë analizës së fakteve dhe provave të paraqitura, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se urdhri nr. 101, datë 1.4.2021 “Për shpërndarjen e Sektorit të Kontrollit për Skemat Kombëtare në Rrethe”, është nxjerrë në kuadër të përmbushjes së detyrave funksionale të institucionit sipas Rregullores së Brendshme ku përcaktohet se “sipas rastit nëpunësi dërgohet me shërbim jashtë qendrës të punës”.

Referuar fakteve dhe rrethanave çmohet se dërgimi i nëpunësit jashtë qendrës së punës për një periudhë kohe të shkurtër, nuk përfshihet në asnjë nga rastet e transferimit të përkohshëm të përcaktuar në nenin 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

Për sa më sipër, veprimtaria do të konsiderohej e ndaluar nëse do të ishte kryer “gjatë fushatës zgjedhore” dhe në kundërshtim me rastet e përligjura. Në kuptim të nenit 91, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë



29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë”.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, kallëzimi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”:

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj zj. Frida Krifca, Drejtore e Përgjithshme e AZHBR-së, pasi nuk konstatohen shkelje të nenit 91, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

